

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË “Gold Perla” SH.P.K.**

Sot më datë 21 Shtator 2018, palët e mëposhtme:

- Znj. Rudina Hakani, e bija e Shkumbinit, e datëlindjes 10 Nentor 1971, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, në rrugen Myslyr Shyri.

shpreh vullnetin e tij për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Gold Perla**” Sh.p.k si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**Gold Perla**” Sh.p.k nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i vetëm si më poshtë:

- Znj.Rudina Hakani, e bija e Shkumbinit, e datëlindjes 10 Nentor 1971, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, në rrugen Myslyr Shyri.

Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Gold Perla**” Sh.p.k do të jetë:

Çdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar, siç mund të ndryshohet herë pas here dhe në veçanti:

- Import/Eksport të aksesorëve të rrobaqepsisë dhe artikujve rrobaqepsije, të metrazheve, të artikujve për modelistiken & stilismin dhe artikuj për trikotazhe.

3. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**Gold Perla**” Sh.p.k do të jetë në Tiranë, në adresën Bulevard Bajram Curri, Pallatet Agimi, Shkalla. 12, nr. pasurise 2/106+12-239/B, Tiranë. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Rudina Hakani
Hakani

4. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

5. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 130,000 (Njëqindetridhjetemijë) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

6. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë "**Gold Perla**" Sh.p.k është **Znj. Laura Muhaj**.


Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "**Gold Perla**" Sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

7. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i vetëm



Rudina Hakani

